



Burlövs  
kommun

etnamesiska  
rtiska Finska Danska Urdu  
a Polska Rumänska Franska Kurdiska  
ngerska Vietnamesiska Ukrainska Spansk Persiska  
talienska Grekiska Finska Danska Urdu Somaliska Tur  
biska Makedonska Polska Rumänska Franska Kurdisk  
a Arabiska Albanska Ungerska Vietnamesiska Ukrainsk  
a Pashto Kinesiska Italienska Grekiska Finska Danska  
a Turkiska Ryska Serbiska Makedonska Polska Rumän  
nska Spansk Persiska Pashto Kinesiska Italienska Gre  
ska Urdu Somaliska Turkiska Ryska Serbiska Makedon  
mänska Franska Kurdiska Dari Engelska Arabiska Alban  
etnamesiska Ukrainska Spansk Persiska Pashto Kinesis  
iska Danska Urdu Somaliska Turkiska Ryska

Albanska

Mësimi i gjuhës amtare në komunën Burlöv



## **Përse fëmiu juaj duhet të mësojë gjuhën amtare?**

Brenda studimeve dhe hulumtimeve shkencore egziston një mbështetje dhe ndihmesë e madhe rreth mësimit të gjuhës amtare. Këtë e dëshmojnë edhe studiues të njohur si Jim Cummins, Ofelia Garcia och Gudrun Svensson të cilët e faktojnë dhe e dëshmojnë se nxënësit të cilët kanë zhvillim/njohuri të plota në gjuhën amtare tregojnë rezultate të larta në shkollë dhe mësojnë në mënyrë shumë më të shpejtë gjuhën suedeze. Njohuritë bazë në gjuhën amtare ndihmojnë dhe lehtësojnë mësimin e gjuhës suedeze natyrisht edhe të lëndëve të tjera në shkollë. Gjuha amtare ka një domethënie të veçantë rreth identitetit, zhvillimit të fëmijës dhe mënyrës së tij të menduarit.

Qëllimi i mësimit të gjuhës amtare është që fëmijës ti ofrohet dhe rritet mundësia e zhvillimit të njohurive/diturive në gjuhën e tij amtare.

## **Kush ka të drejtë në mësimin e gjuhës amtare?**

“Një nxënës, prindi i të cilit flet një gjuhë tjetër (si gjuhë amtare) përveç gjuhës suedeze, atij nxënësi i ofrohet mundësia e mësimit të gjuhës amtare nëqoftëse kjo gjuhë është gjuha e cila shoqëron nxënësin në përditshmërinë e tij dhe njëherit nxënësi posedon njohuritë elementare/bazë në po këtë gjuhë. Nxënësi duhet të ketë njohuritë elementare/bazë në gjuhën e tij amtare e jo të jetë fillestar në të nxënë.

Nxënësi mund të mësojë vetëm një gjuhë si gjuhë amtare pa marrë parasysh se sa gjuhë të tjera ai/ajo flet.

Nxënësit të cilët i takojnë pakicës kombëtare u ofrohet/krijohet mundësia e mësimit të gjuhës amtare edhe nëqoftëse gjuha amtare nuk e shoqëron nxënësin në përditshmërinë e tij.

Nxënësit e adoptuar kanë po ashtu të drejtë në mësimin e gjuhës amtare. Kjo vlen edhe në qoftëse gjuha amtare nuk e shoqëron nxënësin në përditshmërinë e tij.

## **Ajo që nxënësit duhet të dinë në gjuhën amtare është:**

### **Shkolla fillore 1-3**

- Nxënësi duhet që të kuptoj udhëzimet (shprehje) të thjeshta, njëherit dialogje të shkurtëra dhe të thjeshta që janë të përshtatshme dhe përkojnë me moshën e tij/saj.
- Nxënësi mund të thotë fraza standarde në gjuhën amtare.
- Nxënësi duhet që ti njoh shkronjat e alfabetit të gjuhës amtare.

### **Grundskola årskurs 4-6**

- Nxënësi ka përmirësime/zhvillime të theksuara nga një ngecje pasive në përparime aktive/ në të folur (në të shprehur) në bazë të moshës që i përket/takon..
- Nxënësi mund të prezantohet në gjuhën amtare në një mënyrë të thjeshtë dhe të tregon për gjërat e përditshme siç janë familja, shkolla ose diçka tjetër për të cilën ai/ajo shpreh dëshirë ose interesim që të tregoj /flas për të.
- Nxënësi mund të lexoj tekste dhe shprehje të thjeshta që përkojnë me moshën e tij/saj.
- Nxënësi mund të shkruaj tekste të shkurtëra.

### **Shkolla fillore 7-9**

- Nxënësi mund të shprehet me gojë në gjuhën amtare.
- Nxënësi mund të lexoj tekste të ndryshme që i përkojnë moshës së tij/saj dhe të kuptoj përmbajtjen e tekstit.
- Nxënësi mund të shkruaj tekste të llojeve të ndryshme.



## Mësimi i gjuhës amtare në shkollë

Një komunë është e detyruar që të organizoj/ ofroj mësimin e gjuhës amtare nëqoftëse brenda komunës janë së paku një grup prej 5 nxënësish të shkollës fillore dhe njëherit nëqoftëse për dhënien e mësimin në këto gjuhë ekziston mësuesi adekuat/përkatës. Nxënësit të cilët i përkasin pakicës kombëtare dhe si gjuhë amtare kanë psh. gjuhën rome, gjuhën laponeze, gjuhën finlandeze etj mësimi për ta mundësohet varësisht në bazë të kërkesës së nxënësit. Komuna Burlöv ka për qëllim që të gjithë mësuesit e gjuhëve amtare të posedojnë shkollimin adekuat dhe të jenë të licensuar. Mësimi në gjuhën amtare mundësohet/ofrohet pas orarit të zakonshëm të mësimin:

Mësimdhënësit të gjuhës amtare i lejohej/ mundësohet huazimi i një klase edhe në një shkollë tjetër brenda komunës përveç shkollës së cilës nxënësi i përket.

## Regjistrimi/aplikimi për mësimin e gjuhës amtare:

Prindërit duhet të bëjnë kërkesën për regjistrimin e fëmijës/nxënësit në mësimin e gjuhës amtare duke plotësuar formularin elektronik përmes linkut në faqen e komunës.

## [e-tjanster.burlov.se/modersmalsansokan](http://e-tjanster.burlov.se/modersmalsansokan)

Kërkesa/aplikimi për mësimin e gjuhës amtare bëhet gjatë vitit shkollor kur fëmija është ako-

ma në parashkollor (përpara se të fillon klasën e parë) dhe kërkesa/aplikimi për mësimin e gjuhës amtare bëhet më së largu me datë 1maj.

Ne i shiqojmë dhe i shqyrtojmë të gjitha kërkesat/aplikimet nga klasa e parë deri në klasën e nëntë por i pranojmë të gjitha kërkesat/aplikimet e juaja edhe brenda vitit shkollor.

## Prezenca dhe mungesa gjatë orëve të mësimin në gjuhën amtare:

Lënda e gjuhës amtare në shkollë ofrohet/ mundësohet në bazë të dëshirës/vullnetit të lirë të nxënësit, por që nga momenti i vendimit/ mundësimin të mësimin të gjuhës amtare në shkollë ajo bëhet obligative dhe nxënësi duhet të jetë i pranishëm në orën e mësimin të gjuhës amtare. Mungesa e nxënësit i raportohet prindit përmes mesazhit telefonik, adresës elektronike (e-mail adresës) ose përmes V-klass.

## Notimi

Notimi bëhet gjatë peridhës së klasës së 6,7,8,9 dhe në gjimnaz.. Kriteri i notimit në lëndën përkatëse /gjuhën amtare përshkruan kushtin e marrjes së notës së caktuar. Nxënësit të cilit i i rrezikohet së paku nota kaluese E ,prindi i tij/saj informohet në kohën e duhur përpara notimit.

Notimi bëhet njëherë brenda terminin/ gjysmëvjetorit shkollor pa marrë parasysh klasën përkatëse të nxënësit.





## Vklass

### Identifikimi

Identifikimi me emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin e tij në aplikacionin Vklass bëhet përmes:

**[burlov.se/skolportal](http://burlov.se/skolportal)**

Aplikacioni Vklass përdoret/shërben si kanal informimi mes drejtorëve të shkollave dhe mësuesve në komunën përkatëse.

Ju si prindër mund të jeni të informuar rreth rezultatit dhe notimit të fëmijës suaj në shkollë përpara takimit/mbledhjes me mësuesin. Takimin/mbledhjen me mësuesin mund ta bëni edhe përmes aplikacionit Vklass.

### Kalendari/orari i mësimit

Në aplikacionin Vklass përveç orarit të mësimit të fëmijës suaj përsihet edhe aktivitetet të ndryshme sikurse detyra e shtëpisë, teste të ndryshme, takime/mbledhje me mësuesin, eskursionet, planifikime të ndryshme rreth tematikave të ndryshme shkollore rreth të cilave fëmija juaj momentalisht është duke punuar/mësuar në shkollë.

### Komunikimi

Komunikimi ose kontakti me shkollën realizohet përmes adresës elektronike, Pasiqë ju të dërgoni një mesazh elektronik tek mësuesi ose personat

kompetentë në shkollë ju po ashtu do të merrni përgjigjen e duhur nga po këta persona kompetentë. Mbi të gjitha është shumë e rëndësishme që ju të keni të regjistruar një adresë elektronike në Vklass.

### Regjistrimi i mungesave në shkollë:

Ju duhet të raportoni mungesën e fëmijës suaj çdo ditë (të shkruani ditën dhe datën). Nëqoftëse ju nevojitet që të raportoni mungesën e fëmijës suaj gjatë një periudhë të caktuar (psh. për shkak të një vizite te mjeku i dhëmbëve, ju duhet që të shkruani ditën, datën dhe kohën e saktë të vizitës.

## Portali shkollor:

Në faqen Portali shkollor ju si prindër mund të gjeni informacionin e duhur dhe të gjithanshëm rreth sistemit të shkollimit të fëmijës suaj dhe rreth mungesave të tij në shkollë. Në po këtë portal shkollor ju mund të informoheni edhe rreth mungesave të fëmijës suaj në shkollë, menysë së ushqimit në shkollë, ditëve të pushimit dhe informacion të gjerë rreth gjithë vitit shkollor.

**[burlov.se/skolportal](http://burlov.se/skolportal)**